


Bashkia Belsh



Raporti Performancës 2021



Shënim i rëndësishëm

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të zbatimit të buxhetit për vitin 2021 të cilat janë pjesë e Buxhetit Interaktiv – Fakt 2021 të bashkisë Belsh.

<https://public.tableau.com/app/profile/loren5044/viz/Belsh-RaportiiPerformances2021/TDhnaAdministrative?publish=yes>

Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Belsh me asistencën e Projektit Bashki të Forta një Projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe grupin Teknik të Shapo Consulting.

Përmbajtja

Fjalor shpjegues.....	3
Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2021	4
Burimet e Financimit	5
Shpenzimet buxhetore	5
Investimet	7
Administrimi i bashkisë	8
Furnizimi me ujë	10
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	13
Rrjeti rrugor rural	15
Shërbime publike vendore	18
Strehimi Social	20
Arsimi bazëpërfshirë arsimin parashkollor	22

Fjalor shpjegues

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Tasat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhen sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transfertat specifike

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zëri apo projekti buxhetor).

Tregues të performancës së programeve buxhetore. Ndryshe treguesit e performancës së shërbimeve që ofron bashkia për komunitetin e saj. Tregojnë se çfarë është realizuar me fondet buxhetore të buxhetit të bashkisë (qofshin ato nga burimet e saj të financimit apo nga QQ) si përshembull: zgjerimi i rrjetit rrugor, bërja funksionale e kanaleve kulluese apo vaditëse, shtimi i fondit pyjor apo kullosor, rritja e frekuentimit të nxënësve në institucionet e arsimit bazë dhe atij parashkollor etj.

Shenja të përdorura në raport dhe leximi i tyre

Përmirësim



Përkeqësim



E njëjta situatë



Nuk ka informacion



Bashkia Belsh

Bashkia Belsh arriti të mbyllë me sukses një vit ende të vështirë ku pasojat e pandemisë botërore nuk ishin të lehta. Ekonomia vendore në të gjithë sektorët përveç bujqësisë ka pësuar rënie. Më së shumti efektin e pandemisë e kanë ndjerë biznet e vogla kryesisht ato deri në 5 milionë lekë xhiro në vit. Shërbimet edhe pse nën ndikimin e rënies së volumit të xhiros duke u krahasuar me vitin 2020, kur pothuajse u mbyllën totalisht njësitë e bar-restoranteve, e rimorën disi veten në vitin 2021. Bizneset e mëdha kanë pasur një efekt negativ disi më të amortizuar. Në tërësi bizneset pësuan rënie në prodhim e shërbime e për rrjedhojë rënien e fitimit të cilat çuan në rënien e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore që mbledh bashkia për bizneset e shërbimeve. Bashkia karakterizohet nga prodhimi bujqësor dhe blektoral sektor ky shumë pak i prekur nga pandemia, kjo reflektohet në faktin që të ardhurat nga taksat, tarifatat dhe gjithë burimet e vendore të bashkisë janë rritur me rreth 18% krahasuar me vitin 2020. Rritjen më të madhe e kanë pasur të ardhurat nga tarifatat vendore duke reflektuar këtu nivelin e tarifës së pastrimit të qytetit e cila është rritur për të mbuluar koston e shërbimit të pastrimit për shkak të transportit dhe zgjerimit të shërbimit në të gjithë bashkinë.

Buxheti i bashkisë në fund të vitit 2021 rezulton të ketë alokuar rreth 8% më pak fonde sesa një vit më parë duke shtuar reflektuar kështu rënien në projektet e financuara nga qeveria qendrore, të cilat kanë qënë të larta përgjatë tre viteve të fundit për bashkinë Belsh.

Përgjatë vitit 2021 financat e bashkisë janë karakterizuar nga:

- ✿ Ulja e fondeve për investime me rreth 9% kundrejt një viti më parë
- ✿ Mbështetje me shërbime sociale duke zënë një peshë nga më të lartat në buxhetin e bashkisë
- ✿ Ruajtjen e numrit të personelit të bashkisë
- ✿ Rritja e peshës së të ardhurave të veta në totalin e burimeve të financimit të bashkisë.

Ekzekutimi i buxhetit ka arritur të përdorë të gjitha të burimet e financimit, duke arritur eficiencë në përdorimin e tyre në kohë sipas planifikimit buxhetor.

Burimet e Financimit

TË ARDHURAT SIPAS BURIMIT (Në mijë Lekë)		FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
		680,474	927,878	881,776	805,427	109%
Kategoria	Burimi buxhetor	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Fakt Vs Plan 2021 në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhura nga taksat e ndara	6,170	6,401	7,363	6,155	46%
	Të ardhura nga taksat lokale	22,326	32,179	31,311	67,650	120%
	Të ardhura nga tarifa vendore	9,300	18,734	27,733	23,825	116%
	Të ardhurat e tjera	2,761	13,831	17,447	4,430	394%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Për funksionet e deleguara	200,693	235,783	58,921	129,253	46%
	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	176,703	358,551	177,600	76,792	231%
	Transferta e kushtëzuar	434,757	653,282	305,102	268,199	114%
	Transferta e pakushtëzuar	116,448	119,458	150,121	121,058	124%
TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi nga viti i shkuar	88,712	83,993	44,024	45,911	96%





Figura 1. Peshat e burimit të financimit në totalin e të ardhurave të bashkisë

Bashkia vazhdon të këtë një financim që varet nga transfertat e qeverisë qendrore. Të ardhurat nga burimet e veta të financimit janë ende modeste. Burimet e financimit u karakterizuan nga:

- ✿ Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë pësuan rënie me 5% kundrejt vitit 2020 dhe u realizuan në masën 109%, duke tejkaluar planin për vitin 2021 me 9%
- ✿ Peshat e të ardhurave të veta (taksat dhe tarifatat) në total burime financimi është 10% dhe transfertat e qeverisë është 85%
- ✿ Të ardhurat e veta u rritën me 18%
- ✿ Të ardhurat e qeverisë u ulën me 47%, duke reflektuar kështu rënie të fondeve për investime të QQ për bashkinë
- ✿ Realizimin më të ulët e kanë taksat vendore kundrejt planit 2021.




Dy fjalë mbi shpenzimet

Shpenzimet buxhetore për vitin 2021 shënuan rënie kundrejt vitit 2020 me rreth 8%, duke reflektuar kështu rënien e fondeve të qeverisë qendrore për investime, ndërkohë që realizimi i tyre kundrejt planit të vitit 2021 ishte rreth 138%, ose një tejkalim prej 38% i planit fillestar të bashkisë si rrjedhojë e investimeve për projektin e ujësjellësit i cili është financuar me fondet e buxhetit të shtetit. Bashkia ofron një numër të madh shërbimesh për popullatën duke filluar nga administrimi i pyjeve dhe kullotave e deri tek shërbimet e kujdesit social. Peshën më të madhe të financimit nga buxheti i bashkisë e zënë shërbimet e mëposhtme për të cilat bashkia raporton më poshtë edhe në lidhje me performancën e shërbimeve të ofruara nga ato. Kryesisht realizim 100% të planit e kanë shërbimet që kanë një financim pothuajse tërësor nga transfertat e qeverisë qendrore si për shërbimet e kujdesit social.

- ✿ *Furnizimi me ujë*
- ✿ *Kujdesi social për familjet*
- ✿ *Administrata*
- ✿ *Rrjeti rrugor*
- ✿ *Sherbime publike vendore*
- ✿ *Arsimi bazë përfshirë parashkollorin*
- ✿ *Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile*

Investimet

INVESTIMET SIPAS PROGRAMEVE /Shërbimeve (Në mijë Lekë)	FAKT 2019	FAKT 2020	FAKT 2021	PLAN 2021	REALIZIMI 2021 në %
	218,036	421,900	384,509	162,614	236%



Dy fjalë mbi realizimin e investimeve

Bashkia ka investuar për përmirësimin e shërbimeve publike një fond prej 385 milionë Lekë. Kundrejt vitit 2020 investimet kanë rënë me rreth 9%, ndërkohë që kontributi i tyre mbetet i njëjtë në buxhet. Ndërkohë që realizimi i investimeve për vitin 2021 kundrejt planit është në masën 236% (dy herë e gjysëm mbi planin si rrjedhojë e fondeve të marra nga buxheti i shtetit për projektet e ujësjellësit).

Investimet e bashkisë gjatë vitit 2021 kanë shënuar një hap cilësor në menaxhimin financiar:

- ✿ Investimet zënë në fund të vitit 2021 rreth 47% të buxhetit të bashkisë një peshë kjo shumë e rëndësishme kjo që e bën bashkinë Belsh ndër bashkitë me peshën më të lartë të investimeve në të gjithë Shqipërinë
- ✿ Projektet e investimeve kanë synuar përmirësimin e shërbimeve si: sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm (faza e tretë e projektit të financuar nga Ministria e Infrastrukturës), ndricimin rrugor me LED, përmirësimin e banesave të shtresave në nevojë, rrjetin rrugor Qafë Shkallë – Belsh, Dëshiran – Gjolenë, etj), bërjen funksionale të kanaleve kulluese dhe vaditëse, bërjen pjesë në festivalin ndërkombëtar “Art në rrugë” etj..

Administrimi i bashkisë




Figura 4: Kategoritë e shpenzimeve për programin Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi: korrente dhe investim

Qëllimi i programit buxhetor

Rritja e kapaciteteve të administratës dhe qëndrueshmërisë së saj për të ofruar shërbime më të mira për komunitetin

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
→	Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (ndryshimi në numer kundrejt vitit të kaluar)	0	0	0	0
↑	Numri i punonjësve të bashkisë që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %)	12.16	12.16	1.80	2.24
↑	Raporti i numrit total të ditëve të trajnimeve kundrejt numrit total të personave të trajnuar (mesatarisht ditë trajnimi për person në vit)	4.00	2.80	3.20	3.20

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Ditë trajnimi në total	80	70	80	80.
Numri total i personave të trajnuar	20	25	25	25

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri total i punonjësve të bashkisë	222	222	222	223
Numri total i punonjësve të administratës së bashkisë	94	94	88	94
Numri total i punonjësve në njësite shpenzuese	128	128	0	129
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit	27	27	4	5
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë	0	0	0	0
Fondi vjetor i pagave të punonjësve të bashkisë Në mijë lekë	128	128	0	129
Shpenzime për investime Në mijë lekë	1,601	954	4,524	6,466
Shpenzime korente Në mijë lekë	61,374	88,297	64,615	82,563

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për shërbimet mbështetëse për kryetarin e bashkisë, këshillin bashkiak, mbajtjen dhe përditësimin e informacionit, komunikimin me publikun dhe ofrimin e funksioneve të parashikuara me ligj nga administrata e bashkisë në masën 72% të planit 2021. Bashkia shpenzon rreth 9% të buxhetit për administratën. Në këtë program regjistrohen punonjësit, shpenzimet për ta dhe investime që kanë të bëjnë edhe me shërbime të tjera të cilat nuk janë regjistruar si funksione më vehte të bashkisë. Investimet për administratën kanë qenë të pakta gjatë vitit 2021 duke reflektuar kështu prioritetet e tjera që ka pasur gjatë këtij viti përshkak të përmetit dhe pandemisë. Performanca e administratës së bashkisë gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Është përmirësuar respektimit i kuadrit ligjor dhe rregullorja e administratës. Nuk janë marrë masa disiplinore për punonjësit e bashkisë;
- ✿ Janë rritur kapacitetet profesionale të administratë. Janë ofruar trajnime edhe pse në kushte pandemie për personelin e bashkisë;
- ✿ Është zvogëluar numri i personave që kanë lëvizur nga puna duke rritur qëndrueshmërinë e administratës.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Administrimi i bashkisë	1,601	9,540	4,524	6,466	70%
<i>Në mijë Lekë</i>					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Blerje lende inerte				1,411	0%
Kolaudim punimesh			2,868		100%
Mbikqyrje punimesh "Rikonstruksion I pjesshem I ambienteve te Bashkise Belsh"				40	0%

orendi zyra			828	960	86%
Paisje kompjuterike			828		100%

Furnizimi me ujë




Figura 5: Kategoritë e shpenzimeve për programin Furnizimi me ujë: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset brenda në qytet dhe gjithë njësitë administrative të bashkisë.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Orë ujë në ditë (Ndryshimi ditor në orë)	3.90	0.00	0.00	0.00



Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm kundrejt popullsisë totale të bashkisë (në %)	50.00	50.00	50.00	50.00
Të ardhura kundrejt shpenzimeve totale (përfshirë investime dhe amortizimi) (në %)				
Total të ardhura nga tarifa kundrejt shpenzime korente (në %)				

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm	15	15	15	15
Popullata e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm (banorë)	16,706	16,706	16,706	16,706

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Kosto totale për shërbimin e ujit të pijshëm (+ investime dhe amortizimi) nga bashkia Në mijë lekë			257,900	
Popullsia totale e bashkisë	33,411	33,411	33,411	33,411
Të ardhurat nga tarifa e ujit të pijshëm Në mijë lekë				
Total shpenzime operative dhe mirëmbajtje për shërbimin ujit të pijshëm nga bashkia Në mijë lekë	76,991	270,582	4,792	57,990

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm dhe gjithë administrimin e problemeve të furnizimit me ujë, duke siguruar pastërtinë e ujit, çmimin e përrballueshëm dhe sasinë e nevojshme për familjet dhe bizneset në të gjithë bashkinë në masën 464% të planit 2021 (pra rreth 5 herë më shumë sesa plani). Bashkia shpenzon rreth 33% të buxhetit të saj për ofrimin e ujit të pijshëm për komunitetin. Fondet e alokuara për këtë shërbij janë financim i qeverisë qendrore për fazën e tretë të projektit të ujësjellësit. Përgjatë viteve të kaluara ashtu edhe në vitet në vijim do të vazhdojnë investimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të kapaciteteve të zgjeruara në shërbimin lokal të furnizimit me ujë në masën rreth 270 milionë lekë që përfaqësojnë rreth 98% të fondeve të alokuara për këtë shërbim për vitin 2021. Aktualisht uji i pijshëm ofrohet nga UK Belsh, e cila synon të mbulojë koston e ofrimit të shërbimit me anë të tarifave të grumbulluara nga familjet, bizneset dhe institucionet publike. Performanca e shërbimit do të përmirësohet duke realizuar:

- ✧ Ruajtjen e të njëjtit nivel të mbulimit me ujë të pijshëm të familjeve dhe bizneseve dhe vazhdimin e punës për të futur në skemën e furnizimit me këtë shërbim edhe të familieve që nuk e aksesojnë deri më sot
- ✧ Më shumë territor është mbuluar me furnizimin e ujit të pijshëm
- ✧ Rritja e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë të pijshëm për banorët
- ✧ Mbulimi i koston së prodhimit dhe shpërndarjes së ujit të pijshëm nga tarifatat e shërbimit.

Duke qenë se ky është një shërbim në zgjerim bashkia do të mbledhë dhe raportoje të dhëna për sa më sipër në vitet në vazhdim.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Furnizimi me ujë	68,737	263,619	264,116	57,990	455%
Në mije Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Faza e I UJSJELLESIT	67,827	107,700		17,000	0%
Faza e II UJSJELLESIT		100,000		20,000	0%
Faza e III UJSJELLESIT		45,431	137,000	20,000	100%
Projekti			6,216		100%
Supervizimi Faza I	737	2,000	20,200	200	100%
Supervizimi Faza II		1,500	100,700	200	100%
Supervizimi Faza III				200	0%

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët




Figura 6: Kategoritë e shpenzimeve për programin Kujdesi social për familjet dhe fëmijët: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Bashkia në harmoni me politikat kombëtare zhvillon programe për mbështetjen e familjeve dhe fëmijëve në nevojë

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Familjeve në nevojë të mbështetura (Ndryshimi vjetor në numer)				
➔	Fëmijë që kanë përfituar nga shërbimi në qendra sociale dhe rezidenciale (Ndryshimi vjetor në numer)	-10	-1	-1	-1
○	Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale (Ndryshimi vjetor në numër)				
○	Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit (Ndryshimi vjetor në numer)				

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të shërbyer gjithsej ne qendrat sociale	39	38	37	37
Fëmijë të shërbyer në Qendra ditore				
Fëmijë të shërbyer në Qendra rezidenciale				
Familje dhe fëmijë në nevojë të mbështetura nga bashkia				
Fëmijë pa kujdes prindëror që kanë marrë kujdes nga bashkia				
Viktima të dhunës në familje dhe / ose viktima të trafikuar të mbështetura nga bashkia				
Fëmijë të shërbyer në kopshte dhe çerdhe				
Fëmijë në çerdhe				
Fëmijë në kopshte				
Kopshte dhe çerdheve funksionale				
Çerdhe				
Kopshte				
Numri personave të mbështetur me ndihmë ekonomike				

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Shpenzimet për ushqim në qendrat sociale për fëmijë Në mijë lekë	199,908	244,807	128,024	128,024

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ofrimin e shërbimit të kujdesit për famijet dhe fëmijët në nevojë sipas përcaktimeve ligjore si edhe për fëmijët e çerdheve, në masën 188% kundrejt planit 2021.

Bashkia shpenzon në financimin e këtij shërbimi rreth 29% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit tregon se bashkia ka vazhduar mbështetjen për familjet dhe fëmijët në nevojë si :

- ✿ Familje dhe fëmijë në nevojë
- ✿ Fëmijë pa kujdes prindëror
- ✿ Fëmijë në qendra ditore
- ✿ Gra dhe fëmijë viktima të dhunës
- ✿ Fëmijët e shërbyer në çerdhe dhe kopshte

Bashkia ka një infomacion të varfër në lidhje me këtë shërbim kaq kompleks të saj, por do të grumbullojë dhe ofrojë të dhëna që në planifikimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Kujdesi social për familjet dhe fëmijët			1,579		100%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Kolaudim punimesh			84		100%
Kolaudim punimesh permirsimi i Kushteve te Banimit te komunitetit Rom dhe Egjiptian 2016				90	0%
Kolaudim punimesh permirsimi i Kushteve te Banimit te komunitetit te pafavorizuar		54		60	0%
komuniteti pafavorizuar				11,398	0%
Lidhje kontrate e re Ujesjellesi			1,148		100%
Mbikqyrje punimesh permirsimi i Kushteve te Banimit te komunitetit te pafavorizuar		120		120	0%
orendi zyre			430		100%

Rrjeti rrugor rural




Figura 7: Kategoritë e shpenzimeve për programin Rrjeti rrugor rural: korente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i komunikimit ndërllokal, nëpërmjet përmirësimit të rrjetit rrugor

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
<input type="radio"/>	Raporti i rrugëve të asfaltuara ndaj totalit të rrugëve (te asfaltuara, cakull etj) në %	6	6		6
<input type="radio"/>	Rrjeti rrugor (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0		
<input type="radio"/>	Rrugë rurale (rrjeti rural ndryshimi vjetor në km linear)	0	0		
<input type="radio"/>	Rrugë rurale dhe urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	34	-46		1,270
<input type="radio"/>	Rrugë rurale të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	34	-46		1,200
<input type="radio"/>	Rrugë urbane (rrjeti urban ndryshimi vjetor në km linear)	0	0		
<input type="radio"/>	Rrugë urbane të mirëmbajtura në vit (ndryshimi vjetor në km linear)	0	0		70
<input type="radio"/>	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale	3	4		4
<input type="radio"/>	Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rrugor kundrejt rrjetit rrugor në Mijë Lekë për 1 km rrugë rurale + urbane	16	21		26

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për mirëmbajtjen e gjithë rrjetit rrugor të saj qoftë në pjesën urbane apo rurale të saj në masën 88% të planit 2021 në një vlerë prej mbi 69 milionë Lekë ku investimet përfaqësojnë rreth 88% të tyre. Bashkia shpenzon rreth 8% të buxhetit të saj për këtë shërbim. Investimet e rëndësishme në rrjetin rrugor kanë çuar në përmirësimin e performancës së këtij shërbimi i cili tregon se:

- ✱ Janë ulur aksidentet rrugore;
- ✱ Është mirëmbajtur i gjithë rrjeti rrugor, qoftë urban apo rural i bashkisë
- ✱ Është ulur (pothuajse përgjysmuar) kosto mesatare e 1 km linear rrugë të mirëmbajtur, duke përmirësuar kështu eficiencën e përdorimit të parasë publike.

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Km rrugë të mirëmbajtura në vit	1,304	1,258		1,270
Rrugë rurale të mirëmbajtura	1,234	1,188		1,200
Rrugë urbane të mirëmbajtura	70	70		70
Km rrugë të shtruara (asfaltuara + shtruara me cakull) në vit	169	178		187
Rrugë rurale të asfaltuara / shtruara	36	46		55
Rrugë urbane të asfaltuara / shtruara	133	132		132

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrjeti rrugor në km (Total rrugë rurale + urbane / inventari rrugëve)	2,997	2,997		2,997
Rrjeti rrugor urban	2,758	2,758		2,758
Rrjeti rrugor rural	239	239		239
Numri aksidenteve rrugore (këmbësorë + automjete)				
Numri i aksidenteve të automjeteve				
Numri i aksidenteve të këmbësorëve				
Shpenzime buxhetore për menaxhimin e rrjetit rrugor në mijë Lekë	47,370	61,939		77,993
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit rural	8,745	9,971		9,971
Shpenzime për menaxhimin e rrjetit urban	39	108		35

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Rrjeti rrugor rural	40,320	54,709	60,558	69,311	87%
Në mijë Lekë					

Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Demshperblime nga zbatimi I Projektit Ansambli Rilindja Belsh			971		100%
Blerje autoshkalle + kamioni vetshkarkues				5,200	0%
Hartim projekti rruges				2,400	0%
Hartimi i projektit rase Soshte Pajalli			1,000		100%
Kolaudim punimesh' Sistemim, Asfaltim rruga Trojas" Unaza Belsh				120	0%
Mbikqyrje punimesh objekti " Sitemim, Asfaltim I rrugeve te brendshme Bashkia Belsh+ kolaudim +rikonstruksion			1,027	38,265	2.6%
Mbikqyrje Punimesh Rikonstruksion Asfaltim rruges qafshkalle - belsh 2016+ Kolaudim	58			8,290	0%
Mbikqyrje punimesh' Sistemim, Asfaltim rruga Trojas" Unaza Belsh			924	950	100%
projekti			1,989		100%
Projekti azhornimit te tokave bujqesore fshati cerrage Njesia ADM Fierze	1,400			2,376	0%
Projekti azhornimit te tokave bujqesore fshati Kosove Njesia ADM Fierze			3,376	3,000	110%
Rikonstruksion Asfaltim Rruga Dëshirane Gjollene			29,849		100%
Rikonstruksion dhe asfaltim I rruges Belsh Shkendi + Kolaudim	4,457	5,000	42	3,887	1%
Rikonstruksion dhe asfaltim I rruges Qafshkalle-Belsh			5,258	8,000	64%

Rikonstruksion I pjsshem I godines se qendres spitalore Belsh per ambjentet zyresh				4,467	0%
shpronosim per objektin ndertim sistemim asfaltim rruga trojas Bashkia Belsh				1,260	0%
Shpronosime per objektin Ndertim Ansambli i Rilindjes Belsh	1,260	3,668			
Sistemim asfaltim rrugeve te brendshme te fshatrave Bashkia Blesh 2017-2019	29,000	44,997	5,326	37,000	14%

Shërbime publike vendore




Figura 8: Kategoritë e shpenzimeve për programin Shërbime publike vendore: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Përmirësimi i shërbimeve publike vendore për gjithë komunitetin e saj qoftë në qytet apo njësitë administrative.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
↑	Raporti i sipërfaqes së gjelbëruar kundrejt sipërfaqes totale të bashkisë (në %)	0.0	0.0	0.1	0.0
↑	Rrënjë pemë dekorative fondi i pemëve në hapësirat e gjelbërta (Ndryshimi vjetor në numër)	210	210	250	250
○	Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave (Ndryshimi vjetor në %)				
↓	Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit kundrejt totalit të të ardhurave nga tarifat vendore (në %)	1.1	1.5	1.3	1.3
○	Trotuare (Ndryshimi vjetor në km linear)	0.4	0.0		10.0

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka shpenzuar fonde për shërbimet publike të cilat përfshijnë gjelbërimin e hapësirave publike, shtimin dhe përmirësimin e trotuareve, mirëmbajtjen e varrezave publike në masën 91% të planit 2021. Bashkia alokon rreth 6% të buxhetit të saj për këto shërbime. Performanca e këtij shërbimi tregon se:

- ✿ Është rritur fondi i pemëve dhe bimëve dekoruese të ambjenteve publike të gjelbëruara nga bashkia
- ✿ Ruajtja e dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta publike nën administrimin e bashkisë
- ✿ Mirëmbajtja e varrezave publike të bashkisë si pjesë e këtij shërbimi të bashkisë në të njëjtin nivel edhe pse nuk janë shtuar fonde të dedikuara për shtimin e hapësirave apo përmirësimin e tyre.

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Rrënjë pemë të mbjella në vit	210.0	210.0	250.0	250.0
Sipërfaqe e gjelbëruar në vit në Km katrorë	0.0	0.0	0.0	0.0

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Sipërfaqe totale e gjelbër publike në Km2	0	0	0	0
Sipërfaqe totale e bashkisë në Km2	196	196	196	196
Fondi total i pemëve dekorative / gjelbëruese të bashkisë	3,046	3,046	3,516	3,516
Trotuare në km linear	15	15	10	20
Të ardhura nga tarifa e gjelbërimit Në mijë lekë	102	284	300	300
Të ardhurat nga tarifat vendore Në mijë lekë	9,300	18,734	23,825	23,825
Shpenzime për përmirësimin e shërbimit të varrezave publike Në mijë lekë	0	0	0	0

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Shërbime publike vendore	892	144	12,435	13,458	92%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Blerje asfalto beton				6,000	0%
Blerje pajisje per sherbimin			301		100%
Mbikqyrje Ndricimi rrugor solar led			120		100%
Ndricimi rrugor me ndricues solar LED			12,014		100%
Peme dekorative per gjelberim	567	1,263			

Strehimi Social




Figura 9: Kategoritë e shpenzimeve për programin Strehimi Social: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor

Mbështetja e komunitetit me strehim social, duke siguruar kushte minimale banimi për familjet në nevojë.

Trendi	Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
○	Kosto e bashkisë për programin e strehimit social kundrejt numrit total të përfituesve nga (Mije Lekë / përfitues)	1,648	1,831		1,793
○	Numri familjeve të mbështetura me strehim social sipas kategorive (Ndryshimi vjetor në %)	9	0		12

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Familje të mbështetur me strehim social	9	9		12

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fonde të alokuara si mbështetje e bashkisë për strehim social	14,832	16,483		21,518

Dy fjalë mbi performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për projektet e strehimit social duke përmirësuar kushtet e banesave të familjeve në nevojë. Për këtë bashkia ka shpenzuar një fond prej 35 milionë lekë të cilat janë realizuar në masën 162% të planit fillestar, duke përfaqësuar rreth 4% të të gjithë buxhetit të bashkisë për këtë shërbim. Është për t'u theksuar se programi i strehimit social pothuajse ka qenë jo aktiv nga ana e bashkisë gjatë viteve të kaluara. Bashkia ka përmirësuar gjendjen e banesave të rreth 12 familjeve në nevojë përgjatë vitit 2021, nga 9 familje që janë ndihmuar një vit më parë.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Strehimi Social	14,032	12,101	29,202	11,428	264%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Permirësimi i Kushteve të Banimit			29,202	11,428	264%

Arsimi bazëpërfshirë arsimin parashkollor




Figura 10: Kategoritë e shpenzimeve për programin Arsimi bazëpërfshirë arsimin parashkollor: korrente dhe investime

Qëllimi i programit buxhetor:

Mirëarsimimi i popullatës nëpërmjet rritjes së frekuentimit të fëmijëve në sistemin arsimor parashkollor dhe atë bazë.

Trendi



Objektivat dhe Treguesit e Performancës	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në moshën 3-6 vjeç (në %)	70	100	68	68
Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësues (Raporti numrit të mësuesve kundrejt numrit total të nxënësve në arsimin bazë)	10		8	8
Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë)	13		12	12
Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Mijë Lekë/institucion)	1,237	1,045	795	885

Produkte	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Numri klasave funksionale në sistemin parashkollor	32	31	32	32
Numri klasave funksionale në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	137		137	137
Ndërtesa funksionale të arsimit parashkollor dhe atij bazë	37	37	36	36

Të dhëna	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021
Fëmijë të regjistruar në sistemin parashkollor 3-6 vjeç	449	419	455	455
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç	642	419	670	670
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	0	142	160	160
Mësues në sistemin parashkollor	33	32	33	33
Mësues në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	184	0	207	207
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar)	1,778	0	1,600	1,600
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë Në mijë lekë	45,759	38,675	28,616	31,857

Dy fjalë mbi të performancën e shërbimit

Bashkia ka realizuar shpenzime për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit arsimor 9 vjeçar dhe atij parashkollor, pagesën e edukatoreve të kopshteve dhe punonjësve mbështetës të shkollave 9 vjeçare, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave, në masën 90% të planit 2021. Buxheti financon edhe mbështetjen për trajnimin e mëtejshëm të edukatoreve dhe mësuesve. Investimet të vogla në fonde kanë pasur realizim të vogël për shkak të rifokusimit në prioritetet e bashkisë përgjatë vitit 2021, ndërkohë që investimet e kryera bëjnë që të shfrytëzohen ambientet e përmirësuar për të rritur cilësinë e shërbimit në shkollat 9 vjeçare të bashkisë. Bashkia shpenzon për financimin e këtij shërbimi rreth 3% të buxhetit të saj. Performanca e shërbimit gjatë vitit 2021 tregon se:

- ✿ Është ulur niveli i frekuentimit në sistemin parashkollor dhe atë bazë;
- ✿ Është ulur norma mesatare nxënës në klasë dhe nxënës për mësues edhe pse numri i nxënësve që frekuentojnë këtë sistem arsimor është rritur, nëpërmjet rritjes së numrit të mësuesve.
- ✿ Buxheti i alokuar për një institucion arsimor ka rënë

Investimet e realizuara gjatë vitit 2021 janë shumë të pakta në institucionet e sistemit arsimor bazë dhe parashkollor.

INVESTIMET E BASHKISË	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 2021	Plan 2021	Realizimi 2021 në %
Arsimi bazëpërfshirë arsimin parashkollor	17,674	7,798	203	1,721	12%
Në mijë Lekë					
Emërtimi i Projektit	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Plan 2021	Realizimi në %
Rikonstruksion i shkolles 9-vjecare Dragot		6,182	203	1,541	13%
Sistemim dhe ndërtim i terreneve sportive shkolla 9 vjecare Grekan 2019 + kolaudim	2,632	1,364		60	0%
Objekti "Rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare Seferan+ mbikqyrje +kolaudim	14,937	360		120	0%